



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.131 dt.02.10.1998

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Tregëtisë në përbërje të Dejtorisë së Zhvillimit Ekonomik “MBI DISA INVESTIME NE SEKTORIN E TREGUT (2)”, mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PUSHTETIT LOKAL”

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 2.2 milion lekë për Ndërmarrjen e Tregut të Lirë, të cilat në mbështetje të Ligjit Nr.7777, dt.22.12.1993 (neni.8, paragrafi.B, pika.3), do të përdoren për përmirësimin e kushteve të punës, dhe konkretisht :

Ambiente zyrash (kioska)	lekë 1.700.000
Pajisje për zyrat	500.000

TOTALI 2.200.000

2. Të miratojë fondin prej 5 milion lekë për Ndërmarrjen e Tregut të Lirë, për blerjen e një makine teknologjike pastrimi për trajtimin e kazanëve të mbeturinave në tregjet e miratuara të Bashkisë në qytetin e Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI